

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE STANDARDEVE

PROGRAM MËSIMOR PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT

LËNDA: Edukim figurativ

(klasa e tetë)

Tiranë, 2006

1. TË PËRGJITHSHME

Nëpërmjet artit figurativ nxënësit do të dallojnë lidhjet e kësaj fushe arti me llojet e tjera të artit, me lëndët e tjera mësimore dhe me mjedisin ku zhvillohet. Kjo lëndë tregon sesa i lidhur është arti figurativ me jetën tonë të përditshme, duke u siguruar mundësinë nxënësve që të krijojnë punë të ndryshme, duke ndërthurur edukimin figurativ me forma të tjera të artit. Kështu, p.sh., nxënësi mund të krijojë mbasi ka dëgjuar një pjesë muzikore, mund të lidhë një datë historike apo simbol historik me një temë të edukimit figurativ, mund të paraqesë probleme sociale apo zgjidhë probleme të jetës së përditshme nëpërmjet krijimit në edukimin figurativ.

Në këtë program paraqitet numri i orëve vjetore dhe javore, si dhe sasia e orëve të lira cilat do të përdoren nga përdoruesit për qëllime të tjera të nevojshme në mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Formimi artistik i nxënësit do të realizohet duke i pajisur ata me:

Njohuri:

- a) për bazën materiale, proceset dhe teknikat, për përdorimin e tyre në përshtatje me këtë nivel;
- b) të reja për elementet dhe parimet, duke i rimarrë disa prej tyre në një shkallë më të lartë vështirësie;
- c) për përdorimin dhe ndërthurjen (e elementeve dhe të parimeve) me linjat e tjera në mënyrë harmonike;
- d) për përdorimin e simboleve e të tematikave të larmishme në shërbim të idesë dhe përdorimin e bazës materiale e të teknikave të ndryshme në shërbim të përmbajtjes;
- e) për historinë e kulturës në periudha të ndryshme, për artin e mesjetës shqiptar, arkitekturën në lidhje me historinë.

Aftësi:

- a) për vëzhgimin e elementeve e të parimeve të artit në natyrë dhe identifikimin e tyre në vepra arti, duke dalluar stile të artistëve të ndryshëm;
- b) për përshkrimin dhe shpjegimin e veprave të artit të artistëve të ndryshëm në periudha të ndryshme, duke bërë krahasimin e tyre;
- c) për të përzgjedhur elementet e parimet në shërbim të temës;
- d) për zbatimin e njohurive të marra në këtë nivel në krijimtarinë e tyre artistike;
- e) për shpjegimin dhe vlerësimin e punës së tij dhe të shokut, duke u mbështetur në njohuritë e marra deri tani;
- f) për të bashkëpunuar dhe për të krijuar në grup, duke pranuar e duke respektuar mendimin e shokut;
- g) për t'i përdorur njohuritë e marra në jetën e përditshme dhe mjedisin ku jeton.
- h) për përdorimin e bazës materiale dhe të teknikave në kohën e duhur;

- i) për përdorimin e një fjalori të përshtatshëm artistik, të pasuruar më shumë në këtë nivel;
- j) për të kumtuar mendime, ide, emocione nëpërmjet temave të larmishme.

Qëndrime:

- a) për të krijuar në mënyrë të pavarur në bazë të njohurive të marra në këtë nivel;
- b) për të mbajtur qëndrim kritik ndaj një vepre arti;
- c) për të mbrojtur punën e tij dhe për të marrë përgjegjësi;
- d) për të respektuar mendimin e tjetrit.

Vlera:

- a) për respektimin e traditave, të zakoneve dhe kulturave të vendit dhe të huaja dhe për rivlerësimin e tyre në ditët e sotme;
- b) për realizimin e detyrave të klasës dhe të shkollës me seriozitet dhe përgjegjësi.

2. SYNIMET

Programi i edukimit figurativ në klasën e tetë ka si synim t’i formojë nxënësit për të kuptuar artin figurativ dhe shprehur nëpërmjet tij.

Në fund të klasës së tetë nxënësi/sja duhet të jetë i/e aftë:

- Të prodhojë punë me dy e tri përmasa që kumtojnë ide (*mendime, ndjenja, përvoja*) për qëllime të caktuara dhe për një nivel të caktuar, duke përdorur forma të shumëllojshme të artit;
- Të identifikojë parimet e artit (*theksin, ritmin, unitetin, baraspeshën, proporcionin*) dhe t’i përdorë ato në mënyrë të përshtatshme për këtë nivel, kur prodhon punë arti;
- Të shpjegojë si artisti/stja i përdor cilësitë shprehëse të elementeve dhe parimeve të artit për të krijuar efekt tek shikuesi, duke mbrojtur idenë e tij dhe duke u mbështetur tek vepra e artit;
- Të përdorë në mënyrë të saktë fjalorin dhe terminologjinë e artit në përshtatje me këtë nivel.

3. LINJAT E PËRMBAJTJES

Ky program është mbështetur mbi 6 linja, të cilat krijojnë një bazë të fuqishme për të arritur objektivat kryesorë të të mësuarit.

- Baza materiale, procese e teknika;
- Elemente dhe parime;
- Tematika;
- Histori dhe kulturë;
- Analiza, interpretimi, vlerësimi;
- Lidhja ndërlëndore me jetën dhe mjedisin.

4. OBJEKTIVAT, NJOHURITË DHE AFTËSITË KRYESORE SIPAS LINJAVE

Linja I. Baza materiale, proceset, teknikat

Nxënësi/sja duhet të njohë, të përzgjedhë dhe të përdorë materiale, mjete, procese e teknika.

Objektivat

Në fund të kësaj linje nxënësit të jenë në gjendje:

- Të aftësohet në përdorimin e *bazës materiale*, si: lapsi, goma, letra, ngjitësi, gërrshëra, plastelina, bojërat, aparati fotografik, kompjuteri etj.; *teknikave dhe proceseve*, si: akuareli, temper, pasteli, vizatimi, kolazhi, skulptura, instilacioni, stampimi, fotografia, kompjuteri, duke përzgjedhur mjetin e duhur për të ilustruar njohuritë e marra në të gjitha linjat e tjera të programit.
- Të përdorë bazën materiale, teknikën e proceset për të kumtuar ndjenja, mendime dhe emocione.

Bisedë dhe krijim (duke përdorur mjete dhe materiale të ndryshme sipas dëshirës.)

Njohuri (mjete) dhe aftësi kryesore: lapsi, goma, akuareli, pasteli, temperi, kompjuteri, aparati fotografik etj. njohja dhe përdorimi i saktë i materialeve dhe teknikave në ilustrimin e njohurive. Aftësimi për të shprehur ndjenja, mendime dhe emocione.

Linja II. Elemente dhe parime

Nxënësi/sja duhet të njohë e të përdorë elementet dhe parimet e artit në punimet e tij.

Objektivat

Në fund të kësaj linje nxënësit të jenë në gjendje:

- Të njohë dhe të përdorë përsëritjen e linjës për të krijuar sipërfaqe dhe për të modeluar. (*Vijat – p.sh : Natyrë e qetë, e realizuar në teknikën e vizatimit me dritë-hije*).
- Të njohë përdorimin e linjës si drejtuese të syve të shikuesit përgjatë kompozimit *Bisedë-* (*për shembull, për veprën “Krijimi” i Leonardo da Vinçit*).
- Të njohë dhe të krijojë objekte nëpërmjet bashkërendimit të formave organike dhe gjeometrike. (*Format 2 përmasore p.sh: Krijim - vizatimi i objekteve të përdorimit të përditshëm ku ndërthuren format gjeometrike dhe organike*).
- Të kuptojë që hija shfaqet si e kundërta e burimit të dritës. (*Format 3 përmasore p.sh – Fotografi nga momente të ndryshme të ditës dhe shpjegimi i efekteve të dritës dhe kontrastit*).
- Të kuptojë që dritë-hija bëhet e dukshme nëpërmjet burimit të dritës (*Vlerat – p.sh: Krijim - Në diskotekë*).

- Të krijojë sipërfaqen nëpërmjet përsëritjes së vijave, hijeve dhe hapësirës (*Sipërfaqja – p.sh: Endje me materiale të ndryshme, si: fiqe, letra, kashtë etj*).
- Të krijojë duke përdorur ngjyrat e ngrohta dhe te ftohta (*Ngjyra- p.sh: Krijim, kompozim me ngjyra të ngrohta dhe ngjyra të ftohta*).
- Të kuptojë që objektet paraqiten të mëdha kur ato janë afër nesh dhe të vogla kur janë larg. (*Hapësira p.sh: Përdorimi i këtij koncepti tek filmat vizatimorë dhe krijimi i një situatë të tillë*).
- Të njohë, të kuptojë baraspeshën informale (*Baraspesha p.sh: Kompozim i ndarë në dy pjesë (për shembull: “Vera dhe dimri” ose “E mira dhe e keqja” etj.*).
- Të kuptojë që nëse sytë e shikuesit lëvizin përgjatë kompozimit, në përgjithësi, shikimi fillon dhe mbaron në zonën e theksi (*Theksi p.sh: Peizazh ose krijim i lirë*).
- Të njohë dhe të kuptojë lëvizjen, nëpërmjet krijimit të formave organike dhe linjave të harkuara. (*Lëvizja p.sh: Ilustrimi i një poezie të Lasgush Poradecit*).
- Të kuptojë që unifikimi i elementeve të ndryshme kryhet nëpërmjet mbivendosjes, lidhjes, përsëritjes etj. (*Uniteti – p.sh: Bisedë: njohja me veprat e kubistëve dhe krijim duke u mbështetur në veprat e tyre, si: Pikaso, Brak etj*).
- Të krijojë duke përdorur kontrastin dhe variacionin për të krijuar qendrën e interesit për të tërhequr vëmendjen e shikuesit (*Kontrasti p.sh: Krijim i lirë*).
- Të krijojë harmoninë nëpërmjet kombinimit të formave dhe linjave (*Harmonia – p.sh: Skulpturë me baltë ose me plastelinë ose instilacion me objekte të riciklueshme*)

Njohuri dhe aftësi kryesore: vija, ngjyrat e ftohta dhe të ngrohta, forma 2-përmasore, forma gjeometrike dhe organike, forma 3-përmasore dhe vlera, burimi i dritës vë në pah volumin dhe ngjyrat e objekteve; hapësira, objektet afër dhe larg (perspektiva); baraspesha informale; theksi: kontrasti, harmonia dhe lëvizja për të tërhequr vëmendjen.

Përdorimi i duhur i fjalorit artistik, përdorimi i saktë në punën krijuese i njohurive të marra në këtë linjë.

Linja III. Tematika

Nxënësi/sja duhet të shqyrtojë, të përzgjedhë dhe të përdorë shumëllojshmëri temash, simbolesh, idesh nga jeta e tij.

Objektivat

Në fund të kësaj linje nxënësit të jenë në gjendje:

-Të njohë dhe të përdorë simbolin për pasurimin e tematikës. Njohja me simbolet p.sh: *Krijim*.

Njohuri dhe aftësi kryesore: simboli. Aftësimi për të vëzhguar dukurinë dhe thelbin e tij dhe ta shprehë në mënyrë figurative (vizuale).

Linja IV. Historia dhe kultura

Nxënësi/sja duhet të kuptojë edukimin figurativ në lidhje me historinë dhe kulturën.

Objektivat

Në fund të kësaj linje nxënësit të jenë në gjendje:

- Të njohë artin dhe artistët të realizmit socialist (shembuj nga vepra të ndryshme të kësaj periudhe)
- Të njohë arkitekturën e kësaj periudhe (shembuj të ndryshëm nga arkitektura).
- Të njohë dhe të vlerësojë vepra të artit në periudha të ndryshme të historisë së artit (*impresionizmi, ekspresionizmi, simbolizmi* etj.).

Njohuri dhe aftësi kryesore: realizmi socialist në artin figurativ dhe arkitekturë, impresionizmi, ekspresionizmi dhe simbolizmi. Njohja me kushtet dhe rrethanat në të cilat lindi dhe u zhvillua arti dhe arkitektura e realizmit socialist dhe e periudhave të tjera të artit të historisë botërore. Njohja dhe dallimi i periudhave të ndryshme nga njëra - tjetra.

Linja V. Analiza , interpretimi dhe vlerësimi

Nxënësi/sja duhet të vëzhgojë, të përshkruajë, të analizojë, të interpretojë dhe të vlerësojë punën e tij/saj dhe të shokut/qes.

Objektivat

Në fund të kësaj linje nxënësit të jenë në gjendje:

- Të njohë dhe të analizojë fotografinë artistike. Të analizojë dhe të mbajë qëndrim ndaj punës së tij, të shokut dhe veprave të artit p.sh: *Bisedë për fotografë të njohur shqiptarë, si: Marubi, Reli* etj.

Njohuri dhe aftësi kryesore: përshkrimi, analiza, vlerësimi, gjykimi, diçitura (leximi i të dhënave në një vepër arti), komunikimi si një koncept shumë i rëndësishëm. Njohja mirë e elementeve dhe parimeve, e bazës materiale, teknikave dhe e historisë sjell krijimin e koncepteve të qarta të analizës, interpretimit dhe vlerësimit. Mbrojtja e punës dhe liria e mendimit dhe argumentimit.

Linja VI. Lidhja ndërlëndore, me jetën dhe me mjedisin

Nxënësi/sja duhet të bëjë lidhjen mes artit figurativ dhe disiplineve të tjera, si dhe me jetën e përditshme.

Objektivat

Në fund të kësaj linje nxënësit të jenë në gjendje:

- Të njohë simbolet në kultura e kohë të ndryshme (ky objektiv lidhet me objektivin e linjës së tematikës dhe mund të realizohet në një orë të përbashkët) p.sh: *Krijim - logo të ndryshme.*

- Të krijojë punë arti në lidhje me lëndë të ndryshme (të krijojë punë në kompjuter me programe të thjeshta, skenën dhe kukullat për një teatër kukullash, të ideojë këndin e matematikës, të letërsisë apo biologjisë etj. në shkollë).

Njohuri dhe aftësi kryesore: logot, simbolet, njohja me rëndësinë që ka ndërthurja e artit me jetën dhe me lëndë të ndryshme. Përdorimi i artit në zgjidhjen e problemeve të përditshme.

5. SHPËRNDARJA E ORËVE

Në klasën e tetë të arsimit të detyruar 9-vjeçar, edukimi figurativ zhvillohet në 35 javë mësimore me 1 orë në javë. Përdoruesit e këtij programi duhet të kenë parasysh që të planifikojnë orë përsëritjeje të vazhdueshme mbi njohurive të marra.

$$35 \text{ javë} \times 1 \text{ orë} = 35 \text{ orë vjetore}$$

Linjat	Sasia e orëve
Baza materiale, procese e teknika	2 orë
Elemente dhe parime	18 orë
Tematika	2 orë
Histori dhe kulturë	3 orë
Analiza, interpretimi, vlerësimi	2 orë
Lidhjet ndërlëndore, lidhjet me jetën dhe mjedisin	3 orë
Orë të lira	5 orë

Orë të lira

Qëllimi i orëve të lira (deri në 15% e sasisë totale të orëve) janë lënë të lira në dispozicion të mësuesit. Statusi i tyre është sa i detyrueshëm aq edhe fleksibël. Është i detyrueshëm sepse duhen zhvilluar deri në fund të vitit shkollor. Është fleksibël sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është lënë në dorë të mësuesit në bashkëpunim me drejtorinë arsimore, drejtorinë e shkollës dhe me mësuesit e tjerë të shkollës.

Qëllimi i orëve të lira është t'i lërë hapësirat e nevojshme iniciativës dhe krijimtarisë së shkollës për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësve në përputhje me objektivat e programit zyrtar të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Për mbushjen e tyre me material mësimor mund të përdoren burime të ndryshme, por gjithmonë të bëhet kujdes të punohet për arritjen e kërkesave të programit.

Grumbullimi i fakteve, të dhënave të ndryshme kulturore, historike, gjeografike, demografike, mund të kthehen në një burim të vlefshëm për të organizuar orë mësimore interesante.

Organizimi i ekskursioneve në natyrë për kuptimin e njohurive si format simetrike dhe asimetrike të pemët, perspektivën etj., shoqërohen me veprimtari praktike; organizimi i vizitave në qendra të ndryshme kulturore dhe arti (galeri, muze etj.) shoqërohen me vrojtime të pasuara me detyra konkrete të cilat janë në shërbim të një objekti të caktuar të programit; organizimi i konkurseve brenda klasës për një linjë; organizimi i ekspozitave, biseda me artistë të ndryshëm, zhvillimi i një teme me bazë projekti për t'iu përgjigjur gjendjes së klasës etj.; përforcimi i njohurive i shoqëruar me metoda e strategji që fuqizojnë si të nxënësve ashtu edhe mësuesit, janë disa veprimtari rekomanduese për rubrikën e orëve të lira.

Për mbushjen efikase të një pjese të orëve të lira mund të bashkëpunohet edhe me mësuesit e lëndëve të tjera duke hartuar paraprakisht një plan të përbashkët disa orësh që shfrytëzon lidhjet konceptuale ndërlëndore dhe aspektet kroskurrikulare. Nxënësve u jepet një detyrë e cila përfshin njohuri ndërlëndore dhe u shërben arritjes së objektivave të programeve të disa lëndëve dhe objektivave kroskurrikulare.

Shpërndarja dhe varieteti i veprimtarive, duke ju gjetur vendin e duhur përgjatë vitit mësues, është një element i rëndësishëm i zbatimit me sukses të rubrikës të orëve të lira. Kujdes duhet bërë që orët e lira të mos shpërdorohen duke i shfrytëzuar për qëllime rutinë të cilat nuk sjellin risi të reja në kurrikulin shkollor.

6. INTEGRIMI

Programi i edukimit figurativ të klasës së tetë ka një përmbajtje mjaft të pasur në njohuritë që ajo trajton përgjatë tij. Kështu në tema të shumta mund të zhvillohet integrimi i njohurive dhe aftësive me disa lëndë të tjera. Përmes këtij integrimi, nxënësit vazhdojnë të studiojnë njohuritë dhe të aftësohen jo vetëm në një lëndë por në disa. Kështu, edukimi figurativ integrohet dhe gjen të përbashkëta me historinë, edukimin qytetar, gjuhën amtare, edukimin muzikor. Ato ndihmojnë për të integruar njohuritë e saj me këto lëndë, duke i përforcuar ato gjatë krijimeve të ndryshme *Pra* nxënësit mësojnë të ndërtojnë lidhjet ndërmjet kësaj lënde dhe edukimit muzikor, historisë, edukatës qytetare dhe gjeografisë duke gjetur të përbashkëtat si dhe duke kuptuar që ato mund të përdoren në fusha të ndryshme që ata përgatiten.

Integrimi në linjën e Elementeve dhe parimeve mund të bëhet me: biologjinë: bimët dhe natyra, me gjeografinë p.sh: njohja me pasuritë natyrore, me edukimin qytetar p.sh: Të identifikojë dhe të përshkruajë të përbashkëtat me nënkulturat e tjera (cilat janë të përbashkëtat që ai ka me shokët e klasës ose të lagjes ku jeton), me muzikën e Vivaldit “Stinët e vitit”, me gjuhën amtare, pjesë të ndryshme nga L. Poradeci.

Integrimi në linjën e Historisë dhe kulturës, bëhet me lëndën e edukimit muzikor p.sh: Zhvillimi i muzikës dhe i artit figurativ në shek. 19.

Gjithashtu integrimi do të bëhet edhe përmes ndërthurjes së koncepteve bazë të lëndëve me njëra tjetrën, të metodologjive si dhe me shkencat më të përafërta.

Aspektet kros-kurrikulare janë pasur parasysh në shtjellimin e rubrikave të programit. Gjatë zbatimit të tij një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet:

- çështjeve të mjedisit, ndotjes dhe mbrojtjes së tij;
- kulturës së komunikimit (aftësimi të nxënësve për të kuptuar dhe zbatuar informacionin e shkruar në jetën e përditshme;
- mjeteve të informimit si media dhe masmedia, internetit;
- përdorimit të teknologjive të informacionit, mjeteve audio-vizive, kompjuterit;
- përdorimit të gjuhës së huaj;
- edukimit për të drejtat e njeriut;
- çështjeve të barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare;
- atdhedashurisë (informacion kulturor - artistik, ekonomik, social, historik, gjeografik);
- globalizmit.

6. METODOLOGJIA E REALIZIMIT TE PROGRAMIT

Në qendër të metodologjisë së lëndës së edukimit figurativ janë përvoja dhe aftësia e nxënësit, të cilat i formon, i përmirëson dhe i edukon vazhdimisht gjatë procesit mësimor dhe jashtë tij. Në këtë klasë nxënësi vjen me një përvojë dhe aftësi të formuar për moshën nga programi i edukimit figurativ të klasave paraardhëse. Përdoruesit e këtij programi duhet të përdorë forma të larmishme, si:

- Vëzhgimi, ilustrimi.
- Zbërthimi i saktë i temës dhe njohurive.
- Nxitja e veprimtarisë së pavarur.
- Zgjerimi i njohurive për konceptin e marrë.
- Vlerësimi artistik etj.

Edhe në këtë klasë do të vazhdohet të nxitet liria vetjake në krijim, e cila do të thotë që nxënësi të zbatojë njohuritë e marra nga programi, duke ua përshtatur stilit të tij të punës dhe ëndërrimeve të tij.

Është shumë e rëndësishme që bashkëpunimi mësues-nxënës gjatë procesit mësimor të mbështetet edhe në përvojën vetjake të nxënësve.

Mjetet dhe përdorimi i tyre

Përdorimi i mjeteve në punimin artistik është i domosdoshëm për të arritur një nivel të kënaqshëm gjatë veprimtarisë mësimore. Është shumë e rëndësishme që çdo nxënës të ketë kutinë e tij të mjeteve të punës. Në pamundësi të çdo nxënësi me mjete vetjake, mund të përdoren mjetet në grup.

Mjetet më të rëndësishme janë:

Grupi i parë: shkumësa me ngjyra (tetë ngjyra), lapsa me ngjyra, gomë dhe laps i zi HB, lapustila, akuarelet, pastelet.

Grupi i dytë: vinovil, letër ngjitëse, skoç, vizore, gërshërë.

Grupi i tretë: penela të ndryshëm (të disa madhësive, të cilët janë të përcaktuar në paketa të veçanta), fletore vizatimi, fletore për punëdore, letër tabak, kartonë me ngjyra, letër për të shkruar A4.

Grupi i katërt: aparat fotografik (një për të gjithë klasën), kompjuter (sipas mundësive).

Grupi i pestë: mbajtëse për dosjet e punës, mbajtëse për mjetet, enë për të mbajtur ujë për pastrimin e penelave, si dhe për krijimin e ngjyrave me tempera, akualet.

Grupi i gjashtë: mjete për pastrimin, peshqirë të vegjël, kartëpeceta, gazeta.

Vendi i punës

Për të zhvilluar mësimin e edukimit figurative, është shumë e rëndësishme që nxënësi të punojë më një dritë të plotë, me një vend të sigurt, ku mund të mbështesë mjetet e punës, në një vend të ngrohtë, pa lagështirë, të pastër. Vendi më i mirë për orën e edukimit figurative është klasa-studio. Në pamundësi të saj, klasa të ketë kushtet e përshtatshme.

7. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësve edhe në këtë nivel do të bëhet në bazë të arritjeve që realizon në veprimtarinë praktike e krijuese, pra sa ai arrin të realizojë në praktikë nga njohuritë e marra. Një mënyrë tjetër vlerësimi është edhe aftësia analizuese e vlerësuese që nxënësi i bën punës së tij, të shokut apo edhe të një veprë arti. Ky lloj vlerësimi mund të jetë edhe orë më vete kur kemi analizë të veprave të artit, por mund të jetë edhe në fund të një teme të caktuar, kur në diskutim marrin pjesë të gjithë nxënësit. Vlerësimi mund të bëhet ose jo pas çdo teme mësimore ku mësuesi shfaq mendimin e tij për çdo krijim të nxënësit.